



|                         |                         |                         |                         |                         |
|-------------------------|-------------------------|-------------------------|-------------------------|-------------------------|
| Praktikë / Dokumenti    |                         | 16.02.2022              |                         | 2                       |
| Procedurë / Prokurimi   |                         |                         |                         |                         |
| Organizim / Organizimi  |                         |                         |                         |                         |
| Organizimi / Organizimi | Organizimi / Organizimi | Organizimi / Organizimi | Organizimi / Organizimi | Organizimi / Organizimi |
| SKIMSHI                 | 823                     | 2022                    |                         | 119                     |



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.06/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Avdyll Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.06/2022 të datës 06.01.2022, të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat me adresë rruga në Prishtinë, kundër Vendimit me Nr.0821/2021 të datës 24.12.2021 të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 16.02.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. APROVOHET** pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.06/2022 e datës 06.01.2022 e parashtruar nga ankuesi

**II. NDRYSHOHET** Vendimi me Nr.0821/2021 i datës 24.12.2021 i Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë lidhur me masën disiplinore ndaj ankuesit, ashtu që masa disiplinore "ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë pesë (5) vjet", zëvendësohet me masën disiplinore "ndalimi i 30% e pagës për një periudhë tre muaj".

**III. OBLIGOHET** Ministria e Ministrisë së Ekonomisë, që të bëjë zbatimin e këtij vendimit, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, duke bërë ndalimin i 30% e pagës për një periudhë tre muaj, ndërsa të bëhet kompensimi i pjesës tjetër të pagës nga dita e pezullimit deri në ditën e zbatimit të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

Ministrja e Ministrisë së Ekonomisë më datë 21.07.2021 ka parashtruar kërkesë tek Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshëm që ndaj ankuesit Arsim Kuliqi-Kryeshef Ekzekutiv në Agjencisë e Kosovës për Eficiencë të Energjisë të filloj procedura disiplinore pranë Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, ndërsa më datë 30.07.2021 kërkesën për fillim të procedurës disiplinore të arsyetuar e ka dorëzuar tek Kryesuesi i Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë.

Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë më datë 13.08.2021 ka nxjerr Vendim me Nr. 0504 me të cilin ka bërë pezullimin nga detyra të ankuesit, duke e bërë edhe ndalimin e pagës deri në një vendim përfundimtar.

Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë më datë 13.09.2021 ka nxjerr Vendim me Nr.644/21 më të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore *"ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë pesë (5) vjet"*.

Fillimisht Ministrja e Ministrisë së Ekonomisë, më datë 17.09.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.644/21 të datës 13.09.2021 të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë i Ministrisë së Punëve të Brendshme, mirëpo Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka vendosur për ankesën për faktin që ka qenë jofunksional.

Ankuesi, i pakënaqur me Vendimin me Nr.644/21 të datës 13.09.2021 të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes përfaqësuesit të tij fizikisht më datë 11.10.2021 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot:4980/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18.10.2021 ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme. Më datë 26.10.2021 kemi pranuar përgjigje në ankesë nga Sekretariati i Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë.

Kryetari i Kolegjit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, më datë 22.11.2021 ka parashtruar kërkesë për Kryesuesin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të

Kosovës që ankesës së ankuesit ti shtyhet afati për vendosje për dhjetë (10) ditë pune për shkak të rrethanave të funksionimit të Këshillit. Kryesuesi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 22.11.2021 ka nxjerr Vendim VK.nr.56/2021 me të cilin ka aprovuar kërkesën duke bërë vazhdimin e afatit për vendosje edhe për dhjetë (1) ditë pune për ankesën e ankuesi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 08.12.2021 ka nxjerr Vendim me numër A.nr.858/2021 me të cilin ka shfuqizuar Vendimin me Nr.644/21 të datës 13.09.2021 të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, duke e obliguar Këshillin Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë të rishqyrtoj rastin e ankuesit brenda afatit prej 15 ditësh.

Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinorë më datë 24.12.2021 ka nxjerr Vendim me Nr. 0821/2021 me të cilin ka rishqyrtuar rastin e ankuesit dhe i a shqiptuar masën disiplinore *"ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë pesë (5) vjet"*.

Ankuesi, i pakënaqur me Vendimin me Nr.0821/2021 të datës 24.12.2021 të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes përfaqësuesit të tij fizikisht më datë 06.01.2022 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot:19/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.01.2022 ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme. Më datë 25.01.2022 kemi pranuar përgjigje në ankesë nga Sekretariati i Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën me Nr.Prot:19/2022 të datës 06.01.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.0821/2021 të datës 24.12.2021 të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë; Ankesën me Nr.Prot:4980/2021 të datës 11.10.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.644/21 të datës 13.09.2021 të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë; Procesverbalin e datës 10.09.2021 të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë; Kërkesën/Raportim i datës 21.07.2021 nga Ministria e Ministrisë së Ekonomisë; Memorandumin e Mirëkuptimit i datës 26.08.2020; Vendimin e datës 03.07.2021; Vendimin e datës 03.08.2021; Vendimin e datës 17.12.2019; Kërkesën për

përgjigje në ankesë e datës 18.10.2021; Përgjigjen në ankesë e datës 26.10.2021; Raportin përfundimtar i Auditimit i datës 15.06.2021; Kërkesën e datës 30.07.2021 për fillimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit; Shkresat e datës 12.11.2020; Shkresën për leje për pajisje më vulë e datës 17.11.2020; Vendimin e datës 11.12.2020; Vendimin e datës 03.11.2020; Procesverbalin nga komisioni për pajisje me vulë i datës 11.12.2020; emailin e datës 01.06.2021 nga Emailin e datës 01.06.2021 nga Shkresë e datës 17.11.2020; Shkresën për leje për pajisje më vulë e datës 17.12.2020; Procesverbalin nga komisioni për pajisje me vulë i datës 23.02.2021; Vendim i datës 23.02.2021; Vendimin Nr. 01/05 të datës 05.04.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendimin e datës 03.03.2021; Emailin e datës 26.05.2021 nga Emailin e datës 26.05.2021 nga Emailin e datës 26.05.2021 nga B.Morina; Emailin e datës 27.05.2021 nga Shtojcën 2 protokollin i madh; Thirrjen për aplikim e datës 08.02.2021 nga Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë; Formularin e aplikimit; Shkresën për buxhet; Emailin e datës 18.06.2021 nga ankuesi; Emailin e datës 11.06.2021 dhe 30.04.2021 nga Shkresën njoftuese lidhur me procesin e subvencioneve për Biznese dhe Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme e datës 06.05.2021; Vendimin me Nr. 0504 i datës 13.08.2021 i Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë; Vendimin me Nr. 0503 i datës 13.08.2021 i Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Raportin përfundimtar i Auditimit i datës 06.07.2021; Draft raportin e auditimit për komentim i datës 25.06.2021; Emailin e datës 03.08.2021 nga për ankuesin; Raportimin financiar janar-mars i datës 06.04.2021 nga Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë; Shkresë lidhur me shpenzimet janar-mars 2021; Rekapitullimin për muajin janar, shkurt dhe mars 2021; Pasqyrën e rrjedhjes së parasë për periudhën 10 janar deri 31 mars 2021; Qarkullimin në periudhën 01.01.-31.03.2021 nga Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë; Vërtetimin Tatimor i datës 30.03.2021; Raportimi financiar për tremujorin e dytë 01.04-30.06.2021; Raportin e shpenzimeve datë 01.04-30.06.2021; Rekapitullimi për muajin prill, maj dhe qershor 2021; Pasqyrën e rrjedhjes së parasë për periudhën 01.04-30.06.2021; Qarkullimi në periudhë 01.04-30.06.2021; Vërtetim Tatimor i datës 30.06.2021; Përgjigjen në shkresën e datës 04.03.2021; Emailin e datës 29.10.2020 nga Emailin e datës 30.10.2020 nga Vendimin Nr.1955 i datës 03.11.2020; Kërkesë për pajisje me vulë e datës 12.11.2020; Shkresën për pajisje me vule e datës 16.11.2020; Emailin e datës 04.12.2020 nga Emailin e datës 04.12.2020 nga Emailin e datës 16.06.2021 nga Procesverbalin e seancës disiplinore i datës 31.08.2021, 17.08.2021; Emailin e datës 01.02.2021 nga Vendim i datës 25.02.2020; Urdhër obligim për pagesë e datës 08.10.2020; Urdhërblerja e datës 08.10.2020; Ndarjen buxhetore prej një milion euro për subvencione dhe transfere në bazë të ligji për ndaje buxhetore për vitin 2021; Emailin e datës 22.07.2021 nga Emailin e datës 08.10.2021 nga Emailin e datës 08.10.2021 nga ankuesi; Memorandum mirëkuptimi i datës 26.08.2020; Emailin e datës 10.09.2021 dhe 08.09.2021 nga për Kërkesën për KASH 2019-2021 sipas instruksioneve nga Ministri i Financave për përgatitjen e dokumentit e datës 13.03.2018; Emailin e datës 08.09.2021, 07.09.2021 nga Emailin e datës 07.09.2021 nga A.Thaçi për Shkresë e datës 02.04.2021 nga Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë; Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2019-2021 nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik; Tabela 1 e trendëve të financimit 2017-2018 dhe vlerësimet 2019-2021; Tabela e tjera lidhur me

propozimet për politika të reja të cilat organizatat buxhetore i ka përfshire në tabelën 1; Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2020-2022 nga Ministria e Financave; Procesverbal i seancës disiplinore i datës 13.08.2021; Kërkesën për shtyrje të afatit për vendosjen e ankesës e datës 22.11.2021; Vendimin VK.nr.56/2021 i datës 22.11.2021; Vendimin A.nr.858/2021 të datës 08.12.2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 14.01.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 25.01.2022; Procesverbalin e seancës së Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë i datës 21.12.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se ankesa e ankuesit, është pjesërisht e bazuar, sepse:

Ankuesi në ankesën e tij të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që Vendimi me Nr.0821/2021 i datës 24.12.2021 i Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi sepse: me këtë vendim është trajtuar çështja e vulave, ku në vendimin e parë të këtij këshilli, është vërtetuar se pala nuk ka përgjegjësi për këtë çështje; Nuk është trajtuar në mënyrë të drejtë që njëri nga anëtarët e Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë nuk plotëson kushtet për emërim në pozitën e anëtarit sepse nuk ka 3 vite përvojë punë në pozitën e nivelit të lartë drejtues edhe pse ky pretendim është aprovuar nga KPMSHCK, ndërsa Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë është shpall inkompetent për të trajtuar këtë çështje; Po ashtu Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë nuk ka arritur të konstatoj drejtë gjendjen faktike sepse nuk ka arritur saktë të konstatojë ndodhjen e pasojës duke mos marrë për bazë faktin që nga pala procesi i përkrahjes së sektorit privat është anuluar.

Fillimisht Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë në Vendimin me Nr.0821/2021 e datës 24.12.2021 ka trajtuar çështjen e vulave, ku në vendimin e parë të këtij këshilli, është vërtetuar se pala nuk ka përgjegjësi për këtë çështje, ka konstatuar se me Vendimin A.nr.858/2021 të datës 08.12.2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përveç që është shfuqizuar Vendimi me Nr.644/21 i datës 13.09.2021 i Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë është obliguar të rishqyrtoj rastin e ankuesit në pajtim me legjislacionin në fuqi. Me këtë nënkuptoni që Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë ka pasur për obligim të shqyrtoj edhe njëherë gjithë procesin e rastit të ankuesit sepse rasti është kthyer në pikën zero, rrjedhimisht Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë ka shqyrtuar edhe çështjen e vulave respektivisht pajisjen e Agjencisë së Kosovës për Eficiencë të Energjisë me vulë rrethore dhe katrore. Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. 0821/2021 të datës 24.12.2021 lidhur me çështjen e vulave rrethore dhe katrore, ka konstatuar se tek çështja nuk e ka vlerësuar që ankuesi ka përgjegjësi disiplinore lidhur me këtë proces, andaj pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.0821/2021 të datës 24.12.2021, ka potencuar që Agjencia e Kosovës për Eficiencës të Energjisë me rastin e publikimit në web faqe të thirrjes për aplikim me titull *"Thirrja për aplikim për grunde në projektin për zbatimin e masave për EE në sektorin privat"*, pa u bërë zotimet lidhur me këtë është në kundërshtim me nenin 53 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Gjatë shqyrtimit të gjitha provave të lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, i është referuar deklarimit të Zyrtarit Kryesor Financiar të Ekonomisë të dhënë në seancës disiplinore të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë të datës 21.12.2021, ku ndër të tjera ka potencuar se: *"...Zotimi që është kërkuar nga unë është kërkuar në datë 19 mars, ka qenë ditë e premte në orën 15 në 4. Fillimisht se unë nuk kam pas njohuri për asnjë gjë që ka ndodh deri në atë moment. Fillimisht kam mendu ta nënshkruaj, e më pas kam thënë eja të hënën të lutem. Nuk ka qenë ka qenë një zyrtar tjetër. Të hënën ka qenë data 22, e kam refuzuar..."*. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesi me rastin e publikimit të thirrjes për aplikim me titull *"Thirrja për aplikim për grunde në projektin për zbatimin e masave për EE në sektorin privat"*, ka vepruar në kundërshtim me Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Rregullores MF-Nr.01/2019 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Ligjin Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 06/L-079 për Eficiencës të Energjisë.

Bazuar në këtë, ankuesi me veprimet e tij ka bërë shkelja të rënda disiplinore lidhur me moszbatimin e dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale dhe detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi sipas nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 dhe 3.10 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Në bazë të provave të lëndës, ankuesi ka bërë nënshkrimin e kontratave me gjashtëmbëdhjetë (16) përfituesit pa u përfunduar afati i ankesave duke mos respektuar afatet ligjore për ankesë prej 8 ditësh sipas Udhëzimit Administrative (MTI) Nr.01/2018 për Ndarjen e Mjeteve Financiar nga Kategoria Ekonomike e Subvencioneve dhe Trenasferve të Ministrisë së Inovacionit, në këtë rast Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në këtë konstatim por edhe bazuar në deklarimet e ankuesit në seancën disiplinore të datës 31.08.2021 të mbajtur nga Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, ndër të tjera ankuesi pranon që janë nënshkruar kontratat pa kaluar afati për ankesë mirëpo thekson që kjo ka shkuar sipas këshillës së zyrës ligjore.

Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.0821/2021 të datës 24.12.2021, edhe pse ka konstatuar se ankuesi ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 dhe 3.10 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nuk ka arritur të konstatoj saktë nëse ankuesit me veprimet e tij ka shkaktuar ndonjë dëm të riparueshëm për ministrinë, ashtu siç përcaktohet sipas nenit 13 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, i cili përcakton se: *"Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 4.1. Shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 4.2. Shkallën e fajësisë"*.

Po ashtu bazuar në provat e lëndës, ankuesi në cilësinë e Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencisë e Kosovës për Eficiencë të Energjisë, më datë 03.08.2021 ka nxjerr Vendim Nr.0111 me të cilin ka bërë anulimin e procesit për përkrahjen e sektorit privat përmes "Thirrje për Aplikim për grante me projektin për zbatimin e masave EE në sektorin privat", në këtë rast Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, me rastin e vendimmarrjes nuk ka pasur parasysh *përpyekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit* siç parashihet me nenin 13 paragrafi 4 nën paragrafi 4.4 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik.

Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në të gjitha provat e lëndës, si dhe faktin që nuk është shkaktuar dëm për institucionin nga veprimet e ankuesit, atëherë masa disiplinore *"udalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë pesë (5) vjet"*, është masë e rëndë në krahasim me shkeljen, rrjedhimisht masa disiplinore është në kundërshtim me nenin 50 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 13 paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, i cili përcakton se: *"Masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer"*, kështu që në kuptim të nenit 18 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se: *"Kolegjet e Këshillit që shqyrtojnë ankesat, bazuar në paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të këtij neni, kanë të drejtë të ndryshojnë masën disiplinore në rastet kur vërtetohet se nëpunësi civil e ka kryer shkeljen, mirëpo organi i punësimit nuk i ka shqiptuar masën disiplinore në proporcion me shkeljen e kryer"*, atëherë **ndryshohet** Vendimi me Nr.0821/2021 i datës 24.12.2021 i Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë lidhur me masën disiplinore ndaj ankuesit, ashtu që masa disiplinore *"udalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë pesë (5) vjet"*, zëvendësohet me masën disiplinore *"udalimi i 30% e pagës për një periudhë tre muaj"*.

Në bazë të Vendimit me Nr. 06/83 të datës 11.01.2019 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është emëruar Kryeshef Ekzekutiv në Agjencisë e Kosovës për Eficiencë të Energjisë me mandat tre (3) vjeçar, andaj duke u bazuar në këtë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesit mandati tre (3) vjeçar i ka përfunduar më datë 11.01.2022, në këtë rast nga kjo datë ankuesi nuk ka mandat të ushtrij këtë pozitë. Po ashtu referuar Procesverbalit të seancës disiplinore të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinorë të datës 21.12.2021, ankuesi ka deklaruar se: *"...Unë edhe 15 ditë e përfundoj mandatin ligjërisht dhe kam filluar të punoj në sektorin privat. Vetëm po kërkoj të drejtën time dhe nuk kam ndonjë pretendim që të vazhdoj këtu"*.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ka mandat të obligoj Ministrinë e Ekonomisë që ankuesin ta kthej në vendin e punës Kryeshef Ekzekutiv në Agjencisë e Kosovës për Eficiencë të Energjisë, por në këtë rast obligon Ministrinë e Ministrisë së Ekonomisë, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimin të këtij vendimi, duke bërë

ndalimin e 30% e pagës për një periudhë tre muaj, ndërsa të bëhet kompensimi i pjesës tjetër të pagës nga dita e pezullimit deri në ditën e zbatimit të këtij vendimi.

Po ashtu Njësia e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Ekonomisë, është e obliguar që në pajtim me kompetencat e saj, në kuptim të nenit 51 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 14 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, brenda afateve ligjore të përcaktuar me nenin 51 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Masat disiplinore të shënuara në dosjen e personelit shuhen, pas kalimit të këtyre afateve: dy (2) vjet nga njoftimi i masës së parashikuar në paragrafët 1.1 dhe 1.2 të nenit 47 të këtij ligji"*, të bëjë shuarjen e masës disiplinore ndaj ankuesit.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: *"Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës"*, ndërsa me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të këtij ligji është përcaktuar se: *"Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit"*.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.06/2022

Avdyj BEKTESHI

  
Procesmbajtës

Eshref SHABANI

  
Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dorëzohet:**

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat
- Ministres së Ministrisë së Ekonomisë;



- *Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme;*
- *Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë;*
- *Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme;*
- *Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Ekonomisë dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK- së;*